

LIGJI NR. 08/L-138

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 05/L-057 PËR
THEMELIMIN E FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 05/L-057 PËR
THEMELIMIN E FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Neni 2

Neni 1, në paragrafin 1. dhe në tërë tekstin e ligjit bazik (me përjashtim të nenit 3, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.21.), pas shkurtesës ‘NMVM’, shtohet teksti si vijon: “apo fermerët me numër identifikues të fermës”.

Neni 3

Neni 1 i ligjit bazik, paragrafi 2., pas fjalëve “kredi të caktuara”, shtohen fjalët “apo portfolio kreditore”.

Neni 4

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.6., pas fjalës “lizing”, shtohen fjalët “portfolio kreditore”.

2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.7., pas fjalës “Kredi”, shtohet teksti “lizing, portfolio kreditore apo instrument tjetër financiar”.

3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.12., teksti “procedurat e përmbartimit dhe inkasimit”, ndryshohet me tekstin “procedurat për mbledhjen e borxhit të përcaktuara me Marrëveshjen e Garancisë”.

4. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.13., ndryshohet me tekstin si vijon:

1.13. tarifat – tarifat që paguhen nga Institucioni i Regjistruar Financiar për FKGK-në siç është përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.

5. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.14., teksti “që nuk tejkalon 50% të kryegjësë së papaguar”, ndryshohet me tekstin “që nuk tejkalon tetëdhjetë për qind (80%) të kryegjësë së papaguar.”

6. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.23., teksti “NMVM e Kualifikuara” ndryshohet me tekstin “Kredi marres i Kualifikuar”.

7. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.25., ndryshohet me tekstin si në vijim:

1.25. palët e ndërlidhura – nënkupton dy apo më tepër persona fizikë, juridikë apo të dyja të cilët janë të ndërlidhur, direkt apo indirekt me NMVM-të apo fermerin/ët e regjistruar në Regjistrin e Fermerëve në ministrinë përgjegjëse për bujqësi dhe të pajisur me Numër Identifikues të Fermës në atë mënyrë që qëndrueshmëria financiare e cilitdo prej tyre mund të ndikojë në qëndrueshmërinë financiare të ndonjërit apo të gjithëve apo nëse si rezultat i strukturës së marrëdhënieve të tyre personi tjetër është përfundimisht përgjegjës për shumën e kredisë aktive. Për më tepër, palë e ndërlidhur konsiderohet çdo person tjetër i ndërlidhur me NMVM-të apo fermerin/ët e regjistruar në Regjistrin e Fermerëve në ministrinë përgjegjëse për bujqësi dhe të pajisur me Numër Identifikues të Fermës siç përcaktohet nga FKGK-ja me politikat e brendshme të miratuara nga Bordi i Drejtorëve i FKGK-së në përputhje me këtë ligj.

8. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas nën-paragrafit 1.28., shtohet paragrafi i ri 1.29. me tekstin si në vijim:

1.29. Fermerët me Numër Identifikues të Fermës – nënkupton fermerët e regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin e Fermerëve që mirëmbahet nga ministria përgjegjëse për bujqësi dhe të pajisur me Numër Identifikues të Fermës të cilët janë subjekt i Garancisë Kreditore në pajtim me kriteret e përcaktuara në Marrëveshjen e Garancisë, edhe në rastet kur fermeri përkatës nuk është i regjistruar në ARBK.

Neni 5

Neni 5, paragrafi 6., teksti “bazuar në Përqindjen e Garancisë”, zëvendësohet me tekstin “siç përcaktohet në Marrëveshjen e Garancisë”.

Neni 6

Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.6., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7. me tekstin si në vijim:

1.7. përjashtimisht nga paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. i këtij neni, kredia mund të përdoret për parapagimin dhe mbylljen e një kredie të mëparshme deri në tridhjetë për qind (30%) të shumës totale të kredisë së re që vihet nën mbulimin e Garancisë Kreditore, siç përcaktohet me Marrëveshjen e Garancisë

Neni 7

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 2., teksti “brenda 15 ditëve”, ndryshohet me tekstin “brenda afatit të përcaktuar në Marrëveshjen e Garancisë”.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 2., nën-paragrafi 2.1., fshihet fjala “e Garancisë”.

Neni 8

Neni 8 i ligji bazik, ndryshohet me tekstin si vijon:

Neni 8

Tarifat dhe provizionet

1. Institucioni i regjistruar financiar i paguan FKGK-së tarifën e garancisë në kohën kur kredia i nënshtrohet Garancisë Kreditore në FKGK, si dhe çdo vit pas kësaj, për shumën e mbetur të papaguar të kryegjësë së kredisë së garantuar.

2. Përveç tarifës së garancisë sipas paragrafit 1. të këtij neni, e cila përbën tarifën bazike që aplikohet nga FKGK-ja për institucionet e regjistruara financiare, FKGK-ja mund të aplikojë edhe tarifat në vijim për shërbimet e ofruara:

2.1. tarifën e angazhimit;

2.2. tarifën e mirëmbajtjes;

2.3. tarifën në nivel të portfolios së garantuar.

3. Tarifa e angazhimit dhe tarifa e mirëmbajtjes janë tarifa plotësuese që mund të aplikohen së bashku më tarifën e garancisë, ndërsa tarifa në nivel të portfolios së garantuar mund të aplikohet si tarifë plotësuese së bashku më tarifën e garancisë ose në mënyrë të veçantë si zëvendësim i tarifës së garancisë.

4. Përqindja dhe metodologjia e kalkulimit të tarifave që aplikohen nga FKGK-ja përcaktohen në Marrëveshjet e Garancisë. Lartësia e tarifave që aplikohen nga FKGK-ja duhet të mbulojë shpenzimet e përgjithshme operative dhe humbjet eventuale kreditore të FKGK-së, të llogaritura në tërë portfolin e saj, për të mundësuar qëndrueshmërinë e FKGK-së. Çfarëdo teprice nga tarifat që tejkalon shpenzimet operative dhe humbjet eventuale kreditore mbahet në FKGK dhe përdoret për rritje të qëndrueshmërisë së FKGK-së.

5. Lartësia e tarifave udhëhiqet nga parimet si vijon:

5.1. funksionimi, menaxhimi dhe administrimi udhëhiqet nga parimi i racionalitetit, eficiencës dhe efektivitetit me shpenzimet administrative dhe kostot tjera, duke siguruar qëndrueshmërinë e FKGK-së, dhe

5.2. FKGK-ja do të ndërmarrë masat e duhura që niveli i tarifave të mos ndikojë në normat e interesit lidhur me financimin e kredive të NMVM-ve apo fermerëve me numër identifikues të fermës në nevojë.

6. FKGK-ja në mënyrë periodike vlerëson nivelet e tarifave dhe metodologjinë e kalkulimit, në raport me qëndrueshmërinë e vet të përgjithshme operative dhe buxhetore dhe vlerësimeve të rrezikut, si dhe i përshtatë ato sipas këtyre vlerësimeve me qëllim të mbulimit të shpenzimeve operative dhe humbjeve kreditore. Institucionet e regjistruara financiare janë përgjegjëse për analizën kreditore dhe vlerësimin e rrezikut të kredive që mbuloohen me garanci kreditore nga FKGK-ja.

7. Tarifat që i ngarkohen institucioneve të regjistruara financiare nuk janë kamatë.

8. Në rrethana të jashtëzakonshme kur shfaqet nevoja për mbështetjen emergjente të ekonomisë së Kosovës ose kur konsiderohet e nevojshme për mbështetjen e mëtutjeshme të një sektori ose aktiviteti të caktuar ekonomik, FKGK-ja me aprovimin paraprak të Bordit të Drejtorëve mund të hyjë në marrëveshje me Qeverinë e Republikës së Kosovës, një apo më shumë donatorë apo institucione financiare ndërkombëtare me qëllim të subvencionimit/pagesës së një ose më shumë tarifave të aplikueshme për institucionet e regjistruara financiare për një ose më shumë dritare garantuese. Shuma e tarifës apo tarifave të aplikueshme që subvencionohen/paguhen, përcaktohet nga FKGK-ja sipas parimeve të përcaktuara në këtë nen.

Neni 9

Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4., fshihet teksti “garancisë të”.

Neni 10

Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. ndryshohet me tekstin si vijon:

1.2. tarifat që paguhen nga institucionet e regjistruara financiare për garanci kreditore.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji nr.08/L-138
4 gusht 2022**

Shpallur me dekretin Nr. DL-274/2022, datë 19.08.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu